



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0478

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani-Kryetare, Batisha Ibrahim-Referuese dhe Vedat Poterqoi-Anëtar sipas Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 (e amendamentuar), duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Bajram Ha.Gashi” B.I, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komunës të Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i qendrës sportive Sezai Sorroi (Izolimi i jashtëm dhe dritare)” me numër të prokurimit 622-24-2735-5-2-1, me 26/07/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Bajram Ha.Gashi” B.I. me nr. 2024/0478, e datës 03/06/2024, kurse vendimi i AK Komunës së Prizrenit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i qendrës sportive Sezai Sorroi (Izolimi i jashtëm dhe dritare)” me numër të prokurimit 622-24-2735-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Bajram Ha.Gashi” B.I.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 21.03.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i qendrës sportive Sezai Sorroi (Izolimi i jashtëm dhe dritare)” me numër të prokurimit 622-24-2735-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 400,000.00 €

Me datë 15.05.2024, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik EBK SH.P.K ne vlere totale te ofertës: 279,999.00 Euro.

Me 21.05.2024 OE “Bajram Ha. Gashi” B.I ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 24.05.2024, Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me 03.06.2024 operatori ekonomik “Bajram Ha. Gashi” B.I ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0478 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

(b) Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së e cila u mbajt me datën 26.07.2024.

(c) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 20.06.2024 ekspertja shqyrtuese ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Bajram Ha. Gashi” B.I ne ankesën e tij/saj nr. 478/24 dhe në seancën për shqyrtim kryesor janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon: me datën 21.05.2024, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim tek AK - Komuna Prizren, të cilën AK sipas vendimit të saj të nxjerr me datën 24.05.2024, konsumon shkelje të re nga neni 108/A, dhe nuk i trajton pretendimet tona ankimore, rrjedhimisht tenton të lidhë kontratë kundërligjore me operator ekonomik oferta e të cilit është me e lartë se oferta jonë dhe me këto veprime përveç se janë shkelur kërkesat kualifikuese është shkelur edhe kriteri i dhënies së kontratës çmimi me i ulët. Sa i përket pikës së parë të eliminimit dhe arsytimit se “Ne CV e ing të emëruar nuk dihet se kure janë të punësuar dhe a janë ende aktiv si punëtor”, për këtë çështje Autoriteti Kontraktues kanë shkelur dispozitat e nenit 59, të LPP-se, lidhur me nenin 40, të rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik. Ne kërkesë kualifikuese të përcaktuar në dosje të tenderit asgjëkund nuk është kërkuar që në CV të inxhinierëve duhet të përshkruhet se kur është punësuar inxhinieri apo edhe a është ende aktiv.

Pretendimi i dytë (II): *Ankuesi pretendon se* “Ky arsyetim i eliminimit i përshkruar nga AK paraqet shkelje të nenit 52, par 3 të LPP-se dhe nenit 56, par 3. Veprimet e tilla kundër ligjore nga Autoriteti Kontraktues, do duhej të ndëshkoheshin dhe do duhej të ndërmerren masa ligjore për shkelje të dispozitave të LPP-se, shkelje të parimeve të prokurimit publik, shkelje këto të konsumuara dhe të përcaktuara me nenin 97, të Rregullores për prokurim Publik nr. 001/2022,

rrjedhimisht kompanisë sonë veprimet e tilla po i shkaktojnë dëme të shumëfishta materiale që nga ofertimi, sigurimi i tenderit, depozita në emër të ankesës dhe kapacitetet tjera njerëzore”.

Pretendimi i tretë (III): *Ankuesi pretendon se* “Arsyetimi i eliminimit me pohimin se në CV të inxhinierit, nuk dihet se kure janë të punësuar”, tregon qartë për integritet të anëtarëve të komisionit vlerësues dhe zyrtarëve tjerë përgjegjës për zbatim të mirëfilltë dhe ligjorë të procedurave të prokurimit. Në kërkesa kualifikuese lidhur me stafin kyç është kërkuar të prezantohen dëshmitë si me poshtë: “CV-ia (e nënshkruar nga vetë inxhinieri), diploma duhet të jetë e noterizuar. Data e noterizimit nuk duhet të jetë më shumë se nëntëdhjetë (6) muaj kalendarik nga data e njoftimit për kontratë. Dëshmi mbi përvojën në punë, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt me OE në fjalë. Të jenë të certifikuar për siguri, shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri”. Pra nuk është kërkuar që në CV, të përshkruhet koha e punësimit i Ligjërimit CV, ka kuptimin e përshkrimit të të dhënave personale në këtë rast të personit fizik apo inxhinierëve, të dhënat profesionale, edukimin, aftësitë dhe shkathësitë dhe certifikimet përgjatë karrierës. Koha e punësimit, përcaktohet në dokument tjetër, ky dokument quhet “Kontrate”, ku njeri nga elementet kryesore është koha e fillimit të punës..! Në si kompani në oferte kemi prezantuar, kontratat e punës dhe kontratat e bashkëpunimit me stafin e aplikuar, kemi prezantuar CV të nënshkruara nga vetë inxhinierët, kemi prezantuar diplomat e noterizuara, dëshmitë mbi përvojën e punës dhe të gjitha kërkesat tjera të aplikuar ndaj stafit të përcaktuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional. Veprimet e tilla, përveç që shkelin dispozitat e sipër përshkruara shkelin parimet baze për prokurim publik siç është ekonomiciteti dhe efikasiteti, përkatësisht mos favorizimi i OE-se të caktuar, arsyetimi i tillë paraqet shkele të nenit 52.3, përkatësisht nenit 56.3 të LPP. Komuna Prizren, tenton të eliminojë ofertën tone bazuar në kërkesa të cilat nuk kanë qenë kërkesa apo kritere të përcaktuara në dosje të tenderit apo njoftim për kontratë. Veprimi si i tillë me nenin 97 të Rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik është i sanksionuar dhe konsiderohet si shkelje e rëndë në prokurim publik. Të gjitha dispozitat e sipër përshkruara janë shkelur nga zyrtarët e AK-se, përkatësisht anëtarët e komisionit vlerësues të ofertave dhe detyrimisht AK përmes zyrtarëve përgjegjës dhe mbikëqyrës të tyre duhet të ndërmarrin masa ligjore ndaj të njëjtëve për abuzim dhe keqpërdorim në prokurim publik, përkatësisht tentim për dëmtim të buxhetit të AK”.

Pretendimi i katërt (IV): *OE pretendon se* “Ngjashëm është vepruar me shkelje ligjore dhe me rastin e arsyetimit të dytë të eliminimit ku është potencuar se Tek skelet nuk ka një deklaratë për posedim të këtyre paisjeve (mungon Deklarata). Në si OE, në oferte kemi prezantuar marrëveshjen e datës 15.04.2024, mbi marrjen në shfrytëzim të mjeteve të punës të aplikuar në dosje të tenderit, ku është prezantuar lista e pajisjeve marrëveshja, certifikata e biznesit dhe dokumenti unik doganor të skeleve, marrëveshja me kompaninë përkatëse- Alpe Shpk. Për pajisjet teknike në si OE në oferte kemi prezantuar marrëveshjen mbi marrjen me qira, kemi prezantuar listën e pajisjeve dhe kemi prezantuar të gjitha dëshmitë tjera ashtu siç është kërkuar në kërkesë kualifikuese”.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “Bajram Ha.Gashi” B.I në vendimin e saj dhe në senacën dëgjimore:

Përfaqësuesi AK- Komuna e Prizrenit në senacen degjimore ka deklaruar: Autoriteti Kontraktues, me datën 24. 05. 2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pabazuar për arsyet në vijim, sa I përket pretendimit ankimore lidhur me inxhinieret pajtohemë që ankuesi I e ka plotësuar këto kërkesa sipas DT kurse nuk pajtohemë me pretendimin nr 2 I cili si I till e bene te papergjegjshem ankuesin per faktin se I njejt i nuk ka ofruar konfom DT sepse tek Kërkesa 4 Të ketë në pronësi edhe këto pajisje teknike: d) Skele te nevojshme për realizimin e projektit. Dëshmia 4 Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë librezat të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhet të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre DUD ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve si dhe për skelat te jepet një deklaratë se i posedon ose i ka marr ne shfrytëzim te dëshmuar me kontratë (tek skelet nuk ka një deklaratë për posedim te këtyre pajisjeve (mungon Deklarata). Dhe të cilat iu bëjnë juve të papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet e OE “Bajram Ha. Gashi” B.I përmes raportit nr. 2024/478 dhe në senacën degjimore ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 te LPP-se, me arsyetimin se ne i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë. Autoriteti kontraktues pas përfundimit te vlerësimit te ofertave e ka njoftuar OE ankues me letrën standarde te tenderuesit te eliminuar, ne te cilën i ka numëruar arsyet e eliminimit: OE ankues eliminohet nga AK-ja, me arsyetimin se ju mungon: Një udhëheqës i punishtes - inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose master i arkitekturës, me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion, një inxhinier i diplomuar i hidroteknikes ose master i hidroteknikes, me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion, një inxhinier i diplomuar i makinerisë ose master i makinerisë, me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion, një inxhinier i diplomuar elektroteknikes ose master i elektroteknikes, me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. OE në fjalë. -b, c, d, e.- CV-ia (e nënshkruar nga vetë inxhinieri), diploma duhet te jete e noterizuar. Data e motorizimit nuk duhet te jete më shumë se nëntëdhjetë (6) muaj kalendarik nga data e njoftimit për kontratë. (Ne CV e ing të emëruar nuk dihet se kur janë të punësuar dhe a janë ende aktive si punëtorë).

Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues te kërkesa nr. 2, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar: Kërkesa 2 - a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose master i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion, - b. Një udhëheqës i punishtes - inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose master i arkitekturës, me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. -c. Një inxhinier i diplomuar i hidroteknikes ose master i hidroteknikes, me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. - d. Një inxhinier i diplomuar i makinerisë ose master i makinerisë, me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. -e. Një inxhinier i diplomuar elektroteknikes ose master i

elektroteknikes, më jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. Dëshmia 2 a. Duhet të caktohet me vendimi menaxheri i projektit, CV-ia (e nënshkruar nga vetë inxhinieri), diploma e menaxherit duhet të jete e noterizuar. Data e noterizimit nuk duhet të jete më shumë se nëntëdhjetë (6)muaj kalendarik nga data e njoftimit për kontratë. Dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt me OE në fjalë. -b, c, d, e.- CV-ia (e nënshkruar nga vetë inxhinieri), diploma duhet të jete e noterizuar. Data e noterizimit nuk duhet të jete më shumë se nëntëdhjetë (6) muaj kalendarik nga data e njoftimit për kontratë. Dëshmi mbi përvojën në punë, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt me OE në fjalë. Të jenë të certifikuar për siguri, shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri. Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i autoritetit kontraktues- Komuna e Prizrenit sepse OE ankues ne ofertën e tij të dorëzuar i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës se dosjes se tenderit, ndërsa ne rast të ndonjë dyshimi AK-ja është dashur të sqarohet sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-se. OE ankues ka marrëveshje bashkëpunimi me inxhinieret ne fjale të cilët ne CV-it e tyre kanë realizuar projekte sipas kërkesës se dosjes se tenderit, andaj ky arsyetim i dhënë nga AK nuk qëndron dhe njëherit sqaroj se OE ankues e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit, po ashtu lidhur me kete konstatim timin u pajtua edhe vet AK gjate senaces.

Konstatimi i dytë (II): Eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues ka ofruar fatura tatimore me të cilat ka dëshmuar se i ka në pronësi një pjesë të skeleve, poashtu ka ofruar edhe një marrëveshje me OE Bajram Gashi B.I dhe OE Alpe Sh.p.k, nga i cili i ka marrë në shfrytëzim skelet dhe për të njëjtat ka dorëzuar si dëshmi të pronësisë DUD-at doganore. Referuar Nenit 2 të kësaj marrëveshje OE ankues e ka plotësuar edhe kërkesën për deklaratë dhe njëherit dëshmitë e përmendura me lartë siç janë faturat tatimore, DUD-at doganore janë dëshmi konkrete se i njëjti i ka ofruar sipas kërkesës se dosjes se tenderit. Këto dëshmi janë të mjaftueshme se nuk përbejnë bazë për eliminimin e ankuesit nga ky aktivitet.

Eksperti shqyrtues, sqaron se në letrën standarde të tenderuesit të eliminuar është cituar nga AK-ja edhe një kërkesë e dosjes se tenderit, mirëpo nuk përmendet si arsyetim i AK-se për eliminim në këtë pikë. Pra, në letrën standarde AK-ja vetëm e ka cituar kërkesën: Kërkesa 2 Në kuadër të stafit duhet të caktohet a. Menaxheri i projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi i Konstruktiv ose master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv - me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion. b. Një inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose master i arkitekturës me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. Lidhur me kërkesën e cituar me lartë, eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues ne ofertën e tij e ka dorëzuar vendimin për caktimin e menaxherit të projektit për të njëjtin ka dorëzuar të gjitha dëshmitë sipas kërkesës dhe poashtu ne ofertën e tij gjenden edhe dëshmitë për inxhinierin e arkitekturës.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues nuk pajtohet për mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërsa operatori ekonomik ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK-së, parashitjet dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues. Duke analizuar të gjitha këto në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështjeje, Paneli krijoi bindjen e tij të pavarur se ankesa e OE ankues duhet të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast, Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar specifikisht në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet me dispozitat e neneve 113 dhe 114 të LPP-së. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Lidhur me arsyet e renditura për eliminimin e ankuesit respektivisht pika 2 të DT kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale eksperti kishte konstatuar se ankuesi i kishte plotësuar ne plotëni dhe sit e tilla nuk qëndrojnë, përfaqësuesi i AK në seancë seancën degjimore, deklaroi se pajtohet me të gjeturat e ekspertit nga ky aspekt, kurse nuk pajtohet me arsyen e dytë respektivisht sipas AK ankuesi nuk e ka plotësuar kërkesën 4 Të ketë në pronësi edhe këto pajisje teknike: d) Skele të nevojshme për realizimin e projektit. Dëshmia 4 Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë librezë të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhet të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre DUD ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve si dhe për skelat të jepet një deklaratë se i posedon ose i ka marrë në shfrytëzim të

dëshmuar me kontratë (tek skelet nuk ka një deklaratë për posedim të këtyre pajisjeve, sepse mungon Deklarata e kërkuar.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim konstaton se ankuesi në ofertën e tij/saj ka paraqitur një marrëveshje ndërmjet Operatorëve Ekonomikë (OE) Bajram Gashi B.I dhe OE Alpe Sh.p.k., nga e cila është marrë në shfrytëzim skeleti. Për këtë qëllim, ai/ajo ka dorëzuar si dëshmi të pronësisë DUD-at doganore. Paneli Shqyrtues, pas analizës së deklarimeve dhe sqarimeve të dhëna, vlerëson se ankuesi ka përmbushur kërkesën e Autoritetit Kontraktues (AK) në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili lejon devijime të vogla që nuk shkaktojnë ndryshime materiale në ofertë.

Megjithatë, paneli sqaron se AK, si iniciator i këtij aktiviteti, ka të drejtë të kërkojë informacione shtesë nga ankuesi për çdo dokument kontestues, nëse ka dilema eventuale dhe janë kontestues sipas stij/saj konform nenit 52 paragrafi 7 i LPP,

Andaj, pa nevojë për detaje tjera shtesë paneli shqyrtues i mbështet argumentet e dhëna të ekspertit shqyrtues i cili ka konstatuar se OE ankues në ofertën e tij e ka dorëzuar vendimin për caktimin e menaxherit të projektit për të njëjtin ka dorëzuar të gjitha dëshmitë sipas kërkesës dhe poashtu në ofertën e tij gjenden edhe dëshmitë për inxhinierin e arkitekturës, andaj mbi bazën e kësaj paneli shqyrtues vlerëson se arsyet e eliminimit të OE ankues janë të paqëndrueshëm andaj paneli shqyrtues vlerëson se aktiviteti i prokurimit duhet të nënshtrohet procesit të rivlerësimit duke qenë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 1,6,7,59 të ligjit për prokurim publik.

-Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminoj ose dëmtoj një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

OSHP niset nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifaës ankimore, për ankuesin, bazuar në nenin 31 par. 4. 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - BAJRAM HA.GASHI B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: